



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 18941 prot.

Shkodër, me 21.07.2026

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, miratuar me Vendimin Nr.60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën e Mërkurë datë 29.07.2026 ora 17:00, me rend dite si më poshtë:

Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 30.06.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2026”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e buxhetit të vitit 2027 dhe programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Shkodër, faza e I-rë”.*
3. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes 200m² të pasurisë së shoqërisë “Tregu i shitjes me shumicë fruta - perime” sh.a tek Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”.*
4. *Projektvendim: “Për miratimin e subjekteve që kërkojnë të njihen si “Posedues Jopronarë” dhe planrilevimet e sipërfaqeve përkatëse në zonat e zhvillimit në territorin e Bashkisë Shkodër”.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të pasurisë me nr.316, vol 6, fq 48 zk 1209 nga pronar shtetin tek Bashkia Shkodër”.*

6. *Projektvendim: "Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore "PrueMos Sheldi", njësia administrative Rrethina, ngastra 50A, për vazhdimin e operimit të antenës së komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare "ONE ALBANIA sh.a".*
 7. *Projektvendim: "Për miratimin e listës së përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti".*
 8. *Projektvendim: "Për miratimin e gjerësisë së zonave të rezervuara për varrezat".*
 9. *Projektvendim: "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Shkodër".*
- *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	E Premte	24.07.2026	10:30
2.	Komisioni për Çështjet Ligjore	E Premte	24.07.2026	11:00
3.	Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike/Komisioni i Kontrollit Financiar	E Premte	24.07.2026	11:30
4.	Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	E Premte	24.07.2026	12:00

Duke Ju falënderuar,

KRYETAR

Oltion LULLI

